**RELACION**

**PËR**

**PROJEKTVENDIMIN**

**"PËR NJË NDRYSHIM DHE DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 466, DATË 30.7.2021 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË BIZNESIT DHE INVESTIMEVE, 2021– 2027, DHE TË PLANIT TË SAJ TË VEPRIMIT", I NDRYSHUAR"**

## I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi i KM "Për një ndryshim dhe disa shtesa në vendimin e KM nr. 466, datë 30.7.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strategjisë së zhvillimit të biznesit dhe investimeve, 2021– 2027, dhe të planit të saj të veprimit", i ndryshuar, propozohet nga Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI), si një dokument politik i qeverisë shqiptare, e cila i kushton vëmendje të veçantë zhvillimit të biznesit dhe investimeve me fokus të orientuar drejt inovacionit dhe njohurive, pjesë e Bashkimit Evropian dhe rajonit, që krijon vende pune të reja dhe cilësore për gratë dhe burrat, që shfrytëzon mundësitë e transformimit dixhital dhe të gjelbër dhe transformimin e zinxhirëve ndërkombëtare të vlerës për zhvillimin e qëndrueshëm dhe të barabartë.

Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve (SZHBI) përbën orientimin kryesor të Qeverisë Shqiptare për zhvillimin ekonomik afat-mesëm, duke u fokusuar kryesisht në zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme si edhe tërheqjen e investimeve. Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI) ka rishikuar strategjinë me qëllim adresimin e piketave përmbyllëse të Kapitullit 20 "Ndërmarrjet dhe politika industriale", e cila kërkon që "*Shqipëria harton dhe fillon zbatimin e një strategjie industriale të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, si dhe një politike për NVM-të në përputhje me politikat përkatëse të BE-së. Shqipëria dëshmon se ka kapacitete administrative adekuate dhe nivel të mjaftueshëm koordinimi midis ministrive dhe agjencive të përfshira*".

Rishikimi i SBZHI për periudhën 2026-2030 është bazuar në rezultatet e raportit të monitorimit të SBZHI 2021-2027 për periudhën 2021-2024 dhe raportin e monitorimit 2025 si edhe legjislacionin e Bashkimit Evropian për politikat industriale dhe sipërmarrjen..

Ekonomia shqiptare ndodhet në një fazë vendimtare të transformimit të saj strukturor, ku konsolidimi i një baze industriale moderne dhe konkurruese përbën shtyllën kryesore për një model rritjeje të bazuar në produktivitet dhe inovacion. Në këtë kontekst, Strategjia e rishikuar për periudhën 2026-2030 përfaqëson vizionin afatgjatë për shfrytëzimin e potencialit të pashfrytëzuar të sektorit prodhues, me synim kalimin nga konkurrueshmëria e bazuar në kosto, drejt asaj të bazuar në cilësi, teknologji dhe vlerë të shtuar. Ky projekt-vendim vjen si një instrument operacional për materializimin e këtij vizioni, duke u harmonizuar me angazhimet e vendit në kuadër të integrimit evropian dhe Kapitullit 20 të *acquis*-it të Bashkimit Evropian. Përmes këtij akti, synohet krijimi i një arkitekture ndërinstitucionale të qëndrueshme, e cila, duke gërshetuar reformat ligjore me instrumente konkrete mbështetëse, do të përshpejtojë integrimin e ndërmarrjeve shqiptare në zinxhirët

## RELACION

## PËR

## PROJEKTVENDIMIN

## "PËR NJË NDRYSHIM DHE DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 466, DATË 30.7.2021 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË BIZNESIT DHE INVESTIMEVE, 2021– 2027, DHE TË PLANIT TË SAJ TË VEPRIMIT", I NDRYSHUAR"

### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi i KM "Për një ndryshim dhe disa shtesa në vendimin e KM nr. 466, datë 30.7.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strategjisë së zhvillimit të biznesit dhe investimeve, 2021– 2027, dhe të planit të saj të veprimit", i ndryshuar, propozohet nga Ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI), si një dokument politik i qeverisë shqiptare, e cila i kushton vëmendje të veçantë zhvillimit të biznesit dhe investimeve me fokus të orientuar drejt inovacionit dhe njohurive, pjesë e Bashkimit Evropian dhe rajonit, që krijon vende pune të reja dhe cilësore për gratë dhe burrat, që shfrytëzon mundësitë e transformimit dixhital dhe të gjelbër dhe transformimin e zinxhirëve ndërkombëtare të vlerës për zhvillimin e qëndrueshëm dhe të barabartë.

Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve (SZHBI) përbën orientimin kryesor të Qeverisë Shqiptare për zhvillimin ekonomik afat-mesëm, duke u fokusuar kryesisht në zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme si edhe tërheqjen e investimeve. Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI) ka rishikuar strategjinë me qëllim adresimin e piketave përmbyllëse të Kapitullit 20 "Ndërmarrjet dhe politika industriale", e cila kërkon që "*Shqipëria harton dhe fillon zbatimin e një strategjie industriale të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, si dhe një politike për NVM-të në përputhje me politikat përkatëse të BE-së. Shqipëria dëshmon se ka kapacitete administrative adekuate dhe nivel të mjaftueshëm koordinimi midis ministrive dhe agjencive të përfshira*".

Rishikimi i SBZHI për periudhën 2026-2030 është bazuar në rezultatet e raportit të monitorimit të SBZHI 2021-2027 për periudhën 2021-2024 dhe raportin e monitorimit 2025 si edhe legjislacionin e Bashkimit Evropian për politikat industriale dhe sipërmarrjen..

Ekonomia shqiptare ndodhet në një fazë vendimtare të transformimit të saj strukturor, ku konsolidimi i një baze industriale moderne dhe konkurruese përbën shtyllën kryesore për një model rritjeje të bazuar në produktivitet dhe inovacion. Në këtë kontekst, Strategjia e rishikuar për periudhën 2026-2030 përfaqëson vizionin afatgjatë për shfrytëzimin e potencialit të pashfrytëzuar të sektorit prodhues, me synim kalimin nga konkurrueshmëria e bazuar në kosto, drejt asaj të bazuar në cilësi, teknologji dhe vlerë të shtuar. Ky projekt-vendim vjen si një instrument operacional për materializimin e këtij vizioni, duke u harmonizuar me angazhimet e vendit në kuadër të integrimit evropian dhe Kapitullit 20 të *acquis*-it të Bashkimit Evropian. Përmes këtij akti, synohet krijimi i një arkitekture ndërinstitucionale të qëndrueshme, e cila, duke gërshetuar reformat ligjore me instrumente konkrete mbështetëse, do të përshpejtojë integrimin e ndërmarrjeve shqiptare në zinxhirët

globale të vlerës. Duke orientuar investimet drejt sektorëve me intensitet të lartë teknologjik dhe duke forcuar ekosistemin e inovacionit, ky projekt-vendim siguron mekanizmat e nevojshëm për të përkthyer prioritetet strategjike në rezultate të prekshme, si rritjen e eksporteve, modernizimin e bazës prodhuese dhe krijimin e vendeve të punës me produktivitet dhe paga më të larta, duke e bërë industrinë shqiptare një aktor dinamik dhe të integruar në tregun e përbashkët evropian.

Strategjia e rishikuar për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve (SBZHI) harmonizon në mënyrë strategjike kuadrin e saj të politikave me objektivat e BE-së për rritjen industriale dhe ekonomike. Një shtyllë qendrore e këtij rishikimi është integrimi i ekosistemeve prioritare – përkatësisht Agropërpunimi, Tekstilet – Veshjet – Lëkura (TCLF), Energjia e pastër dhe eksporti i saj, Metalet bazë dhe lëndët e para kritike (CRM), si dhe përpunimi i drurit dhe turizmi. Duke i dhënë përparësi këtyre sektorëve, strategjia synon të sigurojë shpërndarjen e burimeve, të maksimizojë vlerën e shtuar ekonomike dhe të nxisë një integrim më të thellë në zinxhirët evropianë të vlerës përmes skemave të synuara të nxitjes dhe mbështetjes për inovacionin. Ndryshimi dhe masat e reja në strategjinë e rishikuar reflektojnë nevojat e reja të industrisë dhe integrimit në zinxhirët e vlerës së BE-së në kuadër të proceseve të integrimit evropian.

Rishikimi i SBZHI-së (Strategjisë për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve) zbatohet përmes ndërhyrjeve si në vijim:

- Përfshirja e masave të politikës industriale brenda SBZHI-së: Integrimi i masave të Strategjisë Kombëtare Industriale (SKI) që lidhen me tranzicionin e gjelbër, dixhitalizimin dhe zinxhirët e furnizimit si komponentë ose objektiva specifikë brenda strukturës ekzistuese të SBZHI-së, duke shmangur kështu miratimin e një dokumenti të veçantë strategjik;
- Rishikimi dhe konsolidimi i Planit të Veprimit dhe Buxhetit: Rishikimi i tabelave financiare të VKM-së për të reflektuar një linjë të unifikuar buxhetore dhe të monitorimit për çdo objektiv të politikës, duke siguruar që ndërmarrjet të kenë një pikë të vetme kontakti dhe një dritare të vetme aplikimi për masat mbështetëse.

Ky përditësim strukturor adreson gjithashtu komponentin e reziliencës përmes dy veprimeve konkrete:

- Veprimi prioritar "Rezilienca e zinxhirëve të furnizimit dhe diversifikimi i inputeve (përfshirë CRM)", në përputhje me Aneksin nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- Veprimi prioritar "Standardet, certifikimi dhe gatishmëria për tregun e vetëm (me modul ndërkombëtarizimi)", në përputhje me Aneksin nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Në fushën e dekarbonizimit, Masa M 1.1.4 – Programi i ekonomisë qarkulluese industriale dhe zhvillimi i parqeve eko-industriale është zgjeruar në mënyrë eksplicite për të reflektuar një qasje gjithëpërfshirëse ndaj menaxhimit të mbetjeve. Programi nuk kufizohet te mbetjet e ngurta, por integron si elementë thelbësorë bio-mbetjet dhe trajtimin e ujërave të ndotura industriale. Ky veprim është hartuar për të adresuar kërkesat konkrete të sektorëve të tekstileve, lëkurës dhe agropërpunimit, duke siguruar pajtueshmëri të plotë me Direktivën për

globalë të vlerës. Duke orientuar investimet drejt sektorëve me intensitet të lartë teknologjik dhe duke forcuar ekosistemin e inovacionit, ky projekt-vendim siguron mekanizmat e nevojshëm për të përkthyer prioritetet strategjike në rezultate të prekshme, si rritjen e eksporteve, modernizimin e bazës prodhuese dhe krijimin e vendeve të punës me produktivitet dhe paga më të larta, duke e bërë industrinë shqiptare një aktor dinamik dhe të integruar në tregun e përbashkët evropian.

Strategjia e rishikuar për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve (SBZHI) harmonizon në mënyrë strategjike kuadrin e saj të politikave me objektivat e BE-së për rritjen industriale dhe ekonomike. Një shtyllë qendrore e këtij rishikimi është integrimi i ekosistemeve prioritare – përkatësisht Agropërpunimi, Tekstilet – Veshjet – Lëkura (TCLF), Energjia e pastër dhe eksporti i saj, Metalet bazë dhe lëndët e para kritike (CRM), si dhe përpunimi i drurit dhe turizmi. Duke i dhënë përparësi këtyre sektorëve, strategjia synon të sigurojë shpërndarjen e burimeve, të maksimizojë vlerën e shtuar ekonomike dhe të nxisë një integrim më të thellë në zinxhirët evropianë të vlerës përmes skemave të synuara të nxitjes dhe mbështetjes për inovacionin. Ndryshimi dhe masat e reja në strategjinë e rishikuar reflektojnë nevojat e reja të industrisë dhe integrimit në zinxhirët e vlerës së BE-së në kuadër të proceseve të integrimit evropian.

Rishikimi i SBZHI-së (Strategjisë për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve) zbatohet përmes ndërhyrjeve si në vijim:

- Përfshirja e masave të politikës industriale brenda SBZHI-së: Integrimi i masave të Strategjisë Kombëtare Industriale (SKI) që lidhen me tranzicionin e gjelbër, dixhitalizimin dhe zinxhirët e furnizimit si komponentë ose objektiva specifikë brenda strukturës ekzistuese të SBZHI-së, duke shmangur kështu miratimin e një dokumenti të veçantë strategjik;
- Rishikimi dhe konsolidimi i Planit të Veprimit dhe Buxhetit: Rishikimi i tabelave financiare të VKM-së për të reflektuar një linjë të unifikuar buxhetore dhe të monitorimit për çdo objektiv të politikës, duke siguruar që ndërmarrjet të kenë një pikë të vetme kontakti dhe një dritare të vetme aplikimi për masat mbështetëse.

Ky përditësim strukturor adreson gjithashtu komponentin e reziliencës përmes dy veprimeve konkrete:

- Veprimi prioritar "Rezilienca e zinxhirëve të furnizimit dhe diversifikimi i inputeve (përfshirë CRM)", në përputhje me Aneksin nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- Veprimi prioritar "Standardet, certifikimi dhe gatishmëria për tregun e vetëm (me modul ndërkombëtarizimi)", në përputhje me Aneksin nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Në fushën e dekarbonizimit, Masa M 1.1.4 – Programi i ekonomisë qarkulluese industriale dhe zhvillimi i parqeve eko-industriale është zgjeruar në mënyrë eksplicite për të reflektuar një qasje gjithëpërfshirëse ndaj menaxhimit të mbetjeve. Programi nuk kufizohet te mbetjet e ngurta, por integron si elementë thelbësorë bio-mbetjet dhe trajtimin e ujërave të ndotura industriale. Ky veprim është hartuar për të adresuar kërkesat konkrete të sektorëve të tekstileve, lëkurës dhe agropërpunimit, duke siguruar pajtueshmëri të plotë me Direktivën për

Emetimet Industriale (IED) dhe me acquis-in më të gjerë të BE-së për ekonominë rrethore. Duke adoptuar këtë qasje të integruar, strategjia synon që procesi i dekarbonizimit industrial të mbështetet nga një zinxhir vlerash sa më eficient ndaj burimeve.

Në fushën e tërheqjes së IHD-ve, Masa M 1.1.5 – Programi kombëtar i zhvillimit të klasterave industriale dhe integrimi në zinxhirët e IHD-ve adreson drejtpërdrejt shqetësimet strategjike lidhur me zhvillimin e bazës prodhuese, duke tejkaluar një model që mbështetet vetëm te kostoja e ulët e punës. Duke ripërcaktuar paradigmën e IHD-ve nga "investitorë të izoluar" në "partnerë të ekosistemit", strategjia adreson stimujt të kushtëzuar nga rezultate të matshme në transferimin e teknologjisë dhe zhvillimin e kapaciteteve të furnizuesve vendas. Për të kapërcyer hendekun e "kapacitetit të përthithjes" dhe për të zgjidhur barrierën e komunikimit midis inovacionit në kërkim akademik dhe kërkesave të biznesit, masa synon një strukturë ndërmjetëse: Platformën e Lidhjes IHD–NVM. Përmes këtyre mekanizmave, strategjia e përditësuar siguron që inovacioni të mos jetë thjesht teorik, por i zbatueshëm, duke siguruar një përputhje midis ekspertizës teknike dhe kërkesave të tregut.

Në përputhje me rekomandimin për përmirësimin e kuadrit tonë të monitorimit dhe vlerësimit, Strategjia e rishikuar adreson forcimin e qeverisjes institucionale përmes Masave M 1.2.13 dhe M 1.2.14. Duke ngritur Mekanizmin Ndërinstitucional dhe duke forcuar Sekretariatin Teknik (Njësinë e Analizës dhe Monitorimit të Politikave), ministria synon të forcojë kuadrin e monitorimit, duke siguruar që zbatimi i SBZHI-së të ndiqet jo vetëm nga përmbushja administrative, por nga kontributi i prekshëm në konkurrueshmërinë e ekosistemit industrial shqiptar.

## II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, për Ministrinë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për vitin 2026.

Projektvendimi për rishikimin e "Strategjisë së Zhvillimit të Bizneseve dhe Investimeve 2021 – 2027" lidhet dhe harmonizohet me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2030, më konkretisht me Shtyllën "Zhvillimi i biznesit dhe tregtisë mbrojtja e konkurrencës dhe promovimi i investimeve të huaja". Rishikimi i strategjisë është parashikuar në Planin e Planit Kombëtar të Integrimit Evropian (PKIE) 2026-2028, në Kapitullin 20 "Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale", me afat të miratimit Korrik 2026.

## III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Në zbatim të pikës 2, të VKM nr. 466, datë 30.7.2021 "Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, 2021-2027, dhe planit të veprimit të saj", i ndryshuar, funksionon grupi ndërinstitucional i punës për monitorimin e SBZHI bazuar në Urdhrin e KM nr. 214, datë 13.12.2023 "Për ngritjen e grupit të punës ndërinstitucionale për

Emetimet Industriale (IED) dhe me acquis-in më të gjerë të BE-së për ekonominë rrethore. Duke adoptuar këtë qasje të integruar, strategjia synon që procesi i dekarbonizimit industrial të mbështetet nga një zinxhir vlerash sa më eficient ndaj burimeve.

Në fushën e tërheqjes së IHD-ve, Masa M 1.1.5 – Programi kombëtar i zhvillimit të klasterave industriale dhe integrimi në zinxhirët e IHD-ve adreson drejtpërdrejt shqetësimet strategjike lidhur me zhvillimin e bazës prodhuese, duke tejkaluar një model që mbështetet vetëm te kostoja e ulët e punës. Duke ripërcaktuar paradigmën e IHD-ve nga "investitorë të izoluar" në "partnerë të ekosistemit", strategjia adreson stimujt të kushtëzuar nga rezultate të matshme në transferimin e teknologjisë dhe zhvillimin e kapaciteteve të furnizuesve vendas. Për të kapërcyer hendekun e "kapacitetit të përthithjes" dhe për të zgjidhur barrierën e komunikimit midis inovacionit në kërkim akademik dhe kërkesave të biznesit, masa synon një strukturë ndërmjetëse: Platformën e Lidhjes IHD–NVM. Përmes këtyre mekanizmave, strategjia e përditësuar siguron që inovacioni të mos jetë thjesht teorik, por i zbatueshëm, duke siguruar një përputhje midis ekspertizës teknike dhe kërkesave të tregut.

Në përputhje me rekomandimin për përmirësimin e kuadrit tonë të monitorimit dhe vlerësimit, Strategjia e rishikuar adreson forcimin e qeverisjes institucionale përmes Masave M 1.2.13 dhe M 1.2.14. Duke ngritur Mekanizmin Ndërinstitucional dhe duke forcuar Sekretariatin Teknik (Njësinë e Analizës dhe Monitorimit të Politikave), ministria synon të forcojë kuadrin e monitorimit, duke siguruar që zbatimi i SBZHI-së të ndiqet jo vetëm nga përmbushja administrative, por nga kontributi i prekshëm në konkurrueshmërinë e ekosistemit industrial shqiptar.

## II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, për Ministrinë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për vitin 2026.

Projektvendimi për rishikimin e "Strategjisë së Zhvillimit të Bizneseve dhe Investimeve 2021 – 2027" lidhet dhe harmonizohet me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2030, më konkretisht me Shtyllën "Zhvillimi i biznesit dhe tregtisë mbrojtja e konkurrencës dhe promovimi i investimeve të huaja". Rishikimi i strategjisë është parashikuar në Planin e Planit Kombëtar të Integrimit Evropian (PKIE) 2026-2028, në Kapitullin 20 "Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale", me afat të miratimit Korrik 2026.

## III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Në zbatim të pikës 2, të VKM nr. 466, datë 30.7.2021 "Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, 2021-2027, dhe planit të veprimit të saj", i ndryshuar, funksionon grupi ndërinstitucional i punës për monitorimin e SBZHI bazuar në Urdhrin e KM nr. 214, datë 13.12.2023 "Për ngritjen e grupit të punës ndërinstitucionale për

monitorimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 dhe planit të veprimit të saj". Grupi i punës në periudhën 2021-2026 ka hartuar dy raporte monitorimi:

- Monitorimin dhe raportimin mbi ecurinë e zbatimit të aktiviteteve dhe masave të planit të veprimit të SBZHI 2021-2024, dhe ecurinë e treguesve dhe objektivave.
- Monitorimin dhe raportimin mbi ecurinë e zbatimit të aktiviteteve dhe masave të planit të veprimit të SBZHI 2025, dhe ecurinë e treguesve dhe objektivave.

Bazuar në raportin e fundit të monitorimit të SBZHI 2025 zbatimi i Strategjisë është fokusuar në forcimin e pozicionit të Shqipërisë si një destinacion konkurrues për investimet e huaja direkte (IHD), mbështetjen e ndërkombëtarizimit të bizneseve vendase dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor.

**1. Tërheqja e Investimeve dhe Ndërkombëtarizimi**

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) kanë intensifikuar përpjekjet për promovimin e vendit përmes fushatave të synuara (*outreach*) dhe diplomacisë ekonomike.

- ✓ **Fushata Outreach:** Janë realizuar dy fushata specifike në sektorë me vlerë të shtuar: ICT/BPO dhe manifaktura e pajisjeve mjekësore. Pjesëmarrja në panairin ndërkombëtar MEDICA në Gjermani rezultoi në rreth 15 takime direkte me kompani të interesuara.
- ✓ **Diplomacia Ekonomike:** MEPJ ka koordinuar pjesëmarrjen e Shqipërisë në forume dhe panaire globale si *ITB Berlin 2025*, ku Shqipëria u shpall "Vendi i Nderit", duke rritur ndjeshëm dukshmërinë e potencialit ekonomik dhe turistik të vendit.
- ✓ **Kapacitetet teknike:** Që prej shtatorit 2025, AIDA është abonuar në platformën *FDI Market*, duke përmirësuar procesin e identifikimit të investitorëve përmes të dhënave të strukturuara mbi projektet *greenfield* dhe flukset globale të IHD-ve.

**2. Mbështetja e Eksporteve dhe Digjitalizimi**

Një arritje kryesore për vitin 2025 është miratimi i Programit për Nxitjen dhe Lehtësimin e Eksporteve 2026-2030.

- ✓ **Platforma e Eksporteve:** Është vënë në funksion platforma "*exportalbania.al*", ku deri në fund të 2025 janë regjistruar 155 kompani eksportuese. Në periudhën dhjetor 2025 – janar 2026, platforma regjistroi mbi 4,500 vizitorë.
- ✓ **E-commerce:** AIDA publikoi udhëzuesin "Si të nisësh një Biznes e-commerce" për t'u shërbyer NMVM-ve dhe Startup-eve në procesin e tyre të digjitalizimit.

**3. Shërbimi Aftercare dhe Bashkëpunimi Rajonal**

- ✓ **Përkujdesja ndaj Investitorit:** Përmes nismës "Investor Support Days" dhe takimeve *door-to-door*, AIDA ka kontaktuar gjithsej 112 kompani gjatë 2025, duke adresuar problematikat e tyre në bashkëpunimin me qeverisjen qendrore dhe vendore.
- ✓ **Rrjeti i Bashkëpunimit:** Janë nënshkruar memorandume të rëndësishme bashkëpunimi me agjenci homologe si *Invest North Macedonia, RAS (Serbi), FIPA (Bosnjë dhe Hercegovinë)* dhe *SIMEST (Itali)*, me synim forcimin e investimeve rajonale dhe dypalëshe.

**4. Aksesi në Financë dhe Zhvillimi i Aftësive**

monitorimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 dhe planit të veprimit të saj". Grupi i punës në periudhën 2021-2026 ka hartuar dy raporte monitorimi:

- Monitorimin dhe raportimin mbi ecurinë e zbatimit të aktiviteteve dhe masave të planit të veprimit të SBZHI 2021-2024, dhe ecurinë e treguesve dhe objektivave.
- Monitorimin dhe raportimin mbi ecurinë e zbatimit të aktiviteteve dhe masave të planit të veprimit të SBZHI 2025, dhe ecurinë e treguesve dhe objektivave.

Bazuar në raportin e fundit të monitorimit të SBZHI 2025 zbatimi i Strategjisë është fokusuar në forcimin e pozicionit të Shqipërisë si një destinacion konkurrues për investimet e huaja direkte (IHD), mbështetjen e ndërkombëtarizimit të bizneseve vendase dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor.

**1. Tërheqja e Investimeve dhe Ndërkombëtarizimi**

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) kanë intensifikuar përpjekjet për promovimin e vendit përmes fushatave të synuara (*outreach*) dhe diplomacisë ekonomike.

- ✓ **Fushata Outreach:** Janë realizuar dy fushata specifike në sektorë me vlerë të shtuar: ICT/BPO dhe manifaktura e pajisjeve mjekësore. Pjesëmarrja në panairin ndërkombëtar MEDICA në Gjermani rezultoi në rreth 15 takime direkte me kompani të interesuara.
- ✓ **Diplomacia Ekonomike:** MEPJ ka koordinuar pjesëmarrjen e Shqipërisë në forume dhe panaire globale si *ITB Berlin 2025*, ku Shqipëria u shpall "Vendi i Nderit", duke rritur ndjeshëm dukshmërinë e potencialit ekonomik dhe turistik të vendit.
- ✓ **Kapacitetet teknike:** Që prej shtatorit 2025, AIDA është abonuar në platformën *FDI Market*, duke përmirësuar procesin e identifikimit të investitorëve përmes të dhënave të strukturuara mbi projektet *greenfield* dhe flukset globale të IHD-ve.

**2. Mbështetja e Eksporteve dhe Digjitalizimi**

Një arritje kryesore për vitin 2025 është miratimi i Programit për Nxitjen dhe Lehtësimin e Eksporteve 2026-2030.

- ✓ **Platforma e Eksporteve:** Është vënë në funksion platforma "*exportalbania.al*", ku deri në fund të 2025 janë regjistruar 155 kompani eksportuese. Në periudhën dhjetor 2025 – janar 2026, platforma regjistroi mbi 4,500 vizitorë.
- ✓ **E-commerce:** AIDA publikoi udhëzuesin "Si të nisësh një Biznes e-commerce" për t'u shërbyer NMVM-ve dhe Startup-eve në procesin e tyre të digjitalizimit.

**3. Shërbimi Aftercare dhe Bashkëpunimi Rajonal**

- ✓ **Përkujdesja ndaj Investitorit:** Përmes nismës "Investor Support Days" dhe takimeve *door-to-door*, AIDA ka kontaktuar gjithsej 112 kompani gjatë 2025, duke adresuar problematikat e tyre në bashkëpunimin me qeverisjen qendrore dhe vendore.
- ✓ **Rrjeti i Bashkëpunimit:** Janë nënshkruar memorandume të rëndësishme bashkëpunimi me agjenci homologe si *Invest North Macedonia*, *RAS (Serbi)*, *FIPA (Bosnjë dhe Hercegovinë)* dhe *SIMEST (Itali)*, me synim forcimin e investimeve rajonale dhe dypalëshe.

**4. Aksesi në Financë dhe Zhvillimi i Aftësive**

- ✓ **Portali "Akses në Financë":** Në platformën "one-stop-shop" ka regjistruar mbi 316 mijë angazhime totale gjatë 2025, duke ofruar informacion për rreth 48 thirrje për grante dhe financime.
- ✓ **Trajnimet:** Janë realizuar 12 aktivitete në kuadër të projektit EEN 2025 dhe trajnime specifike për gatishmërinë për eksport me pjesëmarrjen e rreth 60 bizneseve.
- ✓ **Parashikimi i Nevojave:** Është finalizuar Studimi i Nevojave për Aftësi (SNA), i cili pritet të publikohet së shpejti për të orientuar politikat e formimit profesional.

**5. Inovacioni dhe Zonat Ekonomike (TEDA)**

- ✓ **Durana Tech Park:** Viti 2025 shënoi operimin virtual të këtij parku teknologjik, duke u fokusuar në ngritjen e ekosistemit përpara ndërtimit fizik të infrastrukturës.
- ✓ **Financimi i Inovacionit:** AKKSHI ka financuar 14 projekte të Teknologjisë dhe Inovacionit (PTI) që synojnë bashkëpunimin mes universiteteve dhe biznesit.

## IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi propozohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës.

## V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon përafrim me acquis communautaire. SBZHI 2025-2027, por ka adresuar rekomandimet në nenkomitetet dypalëshe Shqipëri-BE sa i takon zhvillimeve në kapitullin 20 të Integrimit Evropian "Ndërmarrjet dhe politika industriale" si edhe kriteret e mbylljes së Kapitullit 20 "Ndërmarrjet dhe politika industriale"

## VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në strategjinë e rishikuar janë shtuar gjithsej 15 masa të reja, duke e përditësuar strategjinë në fuqi në gjithsej 30 masa (12 masa në shtyllën e parë, 13 në shtyllën e dytë dhe 5 masa në shtyllën e tretë).

Projektvendimi propozon si vijon:

- — Ndryshimi i titullit të vendimit në: "Për miratimin e strategjisë së zhvillimit të biznesit dhe investimeve, 2021–2030, dhe të planit të saj të veprimit";
- — Në tabelën 11 "Masat në fushën e ndërhyrjes 'Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi'", shtohen veprimet prioritare për: Programin e ekonomisë qarkulluese industriale; Programin kombëtar të klasterave; Standardet, certifikimin dhe gatishmërinë për tregun e vetëm; Dixhitalizimin industrial; Lehtësimin e veprimtarisë ndërkufitare; Reziliencën e zinxhirëve të furnizimit, Përditësimi i ligjit të investimeve dhe thjeshtimi i procedurave për projektet industriale;
- — Në tabelën 12 "Masat në fushën e ndërhyrjes 'Zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni'", shtohen veprimet prioritare për: Transferimin e teknologjisë; Krijimi i Fondit Shqiptar të Inovacionit (FSHI): Instrumenti Sovran i Bashkëinvestimit për Rritjen e Konkurrueshmërisë dhe Ndërmarrjet me Rritje të Lartë (Scale-Up)",, Përmirësimin e

- ✓ **Portali "Akses në Financë":** Në platformën "one-stop-shop" ka regjistruar mbi 316 mijë angazhime totale gjatë 2025, duke ofruar informacion për rreth 48 thirrje për grante dhe financime.
- ✓ **Trajnimet:** Janë realizuar 12 aktivitete në kuadër të projektit EEN 2025 dhe trajnime specifike për gatishmërinë për eksport me pjesëmarrjen e rreth 60 bizneseve.
- ✓ **Parashikimi i Nevojave:** Është finalizuar Studimi i Nevojave për Aftësi (SNA), i cili pritet të publikohet së shpejti për të orientuar politikat e formimit profesional.

**5. Inovacioni dhe Zonat Ekonomike (TEDA)**

- ✓ **Durana Tech Park:** Viti 2025 shënoi operimin virtual të këtij parku teknologjik, duke u fokusuar në ngritjen e ekosistemit përpara ndërtimit fizik të infrastrukturës.
- ✓ **Financimi i Inovacionit:** AKKSHI ka financuar 14 projekte të Teknologjisë dhe Inovacionit (PTI) që synojnë bashkëpunimin mes universiteteve dhe biznesit.

## IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi propozohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës.

## V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon përafrim me acquis communautaire. SBZHI 2025-2027, por ka adresuar rekomandimet në nenkomitetet dypalëshe Shqipëri-BE sa i takon zhvillimeve në kapitullin 20 të Integrimit Evropian "Ndërmarrjet dhe politika industriale" si edhe kriteret e mbylljes së Kapitullit 20 "Ndërmarrjet dhe politika industriale"

## VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në strategjinë e rishikuar janë shtuar gjithsej 15 masa të reja, duke e përditësuar strategjinë në fuqi në gjithsej 30 masa (12 masa në shtyllën e parë, 13 në shtyllën e dytë dhe 5 masa në shtyllën e tretë).

Projektvendimi propozon si vijon:

— Ndryshimi i titullit të vendimit në: "Për miratimin e strategjisë së zhvillimit të biznesit dhe investimeve, 2021–2030, dhe të planit të saj të veprimit";
— Në tabelën 11 "Masat në fushën e ndërhyrjes 'Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi'", shtohen veprimet prioritare për: Programin e ekonomisë qarkulluese industriale; Programin kombëtar të klasterave; Standardet, certifikimin dhe gatishmërinë për tregun e vetëm; Dixhitalizimin industrial; Lehtësimin e veprimtarisë ndërkufitare; Reziliencën e zinxhirëve të furnizimit, Përditësimi i ligjit të investimeve dhe thjeshtimi i procedurave për projektet industriale;
— Në tabelën 12 "Masat në fushën e ndërhyrjes 'Zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni'", shtohen veprimet prioritare për: Transferimin e teknologjisë; Krijimi i Fondit Shqiptar të Inovacionit (FSHI): Instrumenti Sovran i Bashkëinvestimit për Rritjen e Konkurrueshmërisë dhe Ndërmarrjet me Rritje të Lartë (Scale-Up)",, Përmirësimin e

mjedisit rregullator (SME Test/Pagesat e vonuara); Paketën e dekarbonizimit; Planin e kapaciteteve administrative; dhe Operacionalizimin e mekanizmit ndërinstitucional;

— Në tabelën 13 "Masat në fushën e ndërhyrjes 'Zhvillimi i kapitalit njerëzor'", shtohet veprimi prioritar "Paketa kombëtare e aftësive të gjelbra dhe dixhitale në industri (Green & Digital Upskilling)";

— Zëvendësimi i formatit të planit të veprimit me aneksin nr. 16.

Në pikën II-të, parashikohet ngarkimi i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI), Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Financave, AKSHI-t, Agjencisë "Innovation4Albania", AIC, si dhe strukturave përgjegjëse për Vlerësimin e Ndikimit Rregullator (RIA) në Kryeministri, për zbatimin dhe monitorimin e këtyre masave.

## VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Financave, AKSHI-t, Agjencia "Innovation4Albania", AIC, struktura përgjegjëse për Vlerësimin e Ndikimit Rregullator (RIA) në Kryeministri si edhe institucione të tjera shtetërore përfshirë njësitë e vetqeverisjes vendore të cilat hartojnë dhe zbatojnë nisma për zhvillimin ekonomik.

## VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit. Startegjia ka ndjekur procedurën e konsultimit publik përmes organizimit të tryezave me përfaqësues të sektorit publik dhe privat dhe akademisë. Në aneksin 1, bashkëlidhur relacioni pasqyrohet një përmbledhje e komenteve dhe adresimet që i janë berë në strategjinë e rishikuar.

Projektvendimi do të dërgohet për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave, Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës, Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Ministrisë së Arsimit, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator, si edhe SASPAK.

## IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Financimi i strategjisë së rishikuar do të bëhet nga Buxheti i Shtetit për Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit brenda tavaneve buxhetore sipas parashikimeve buxhetore afatmesme dhe afatgjata në PBA 2026-2028, në programin buxhetor 04130 "Mbështetje për Zhvillim Ekonomik", e detajuar si vijon:

- **Shtylla 1.1 "Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi"**

Rishikimi i Shtyllës 1.1 "Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi" reflekton një ndërhyrje të rëndësishme në politikat e zhvillimit ekonomik, duke e zhvendosur fokusin nga

mjedisit rregullator (SME Test/Pagesat e vonuara); Paketën e dekarbonizimit; Planin e kapaciteteve administrative; dhe Operacionalizimin e mekanizmit ndërinstitucional;

— Në tabelën 13 "Masat në fushën e ndërhyrjes 'Zhvillimi i kapitalit njerëzor'", shtohet veprimi prioritar "Paketa kombëtare e aftësive të gjelbra dhe dixhitale në industri (Green & Digital Upskilling)";

— Zëvendësimi i formatit të planit të veprimit me aneksin nr. 16.

Në pikën II-të, parashikohet ngarkimi i Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI), Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Financave, AKSHI-t, Agjencisë "Innovation4Albania", AIC, si dhe strukturave përgjegjëse për Vlerësimin e Ndikimit Rregullator (RIA) në Kryeministri, për zbatimin dhe monitorimin e këtyre masave.

## VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Financave, AKSHI-t, Agjencia "Innovation4Albania", AIC, struktura përgjegjëse për Vlerësimin e Ndikimit Rregullator (RIA) në Kryeministri si edhe institucione të tjera shtetërore përfshirë njësitë e vetqeverisjes vendore të cilat hartojnë dhe zbatojnë nisma për zhvillimin ekonomik.

## VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit. Startegjia ka ndjekur procedurën e konsultimit publik përmes organizimit të tryezave me përfaqësues të sektorit publik dhe privat dhe akademisë. Në aneksin 1, bashkëlidhur relacioni pasqyrohet një përmbledhje e komenteve dhe adresimet që i janë berë në strategjinë e rishikuar.

Projektvendimi do të dërgohet për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave, Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës, Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, Ministrisë së Arsimit, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator, si edhe SASPAK.

## IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Financimi i strategjisë së rishikuar do të bëhet nga Buxheti i Shtetit për Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit brenda tavaneve buxhetore sipas parashikimeve buxhetore afatmesme dhe afatgjata në PBA 2026-2028, në programin buxhetor 04130 "Mbështetje për Zhvillim Ekonomik", e detajuar si vijon:

- **Shtylla 1.1 "Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi"**

Rishikimi i Shtyllës 1.1 "Tërheqja e investimeve dhe ndërkombëtarizimi" reflekton një ndërhyrje të rëndësishme në politikat e zhvillimit ekonomik, duke e zhvendosur fokusin nga

asistenca teknike e drejtpërdrejtë drejt ndërtimit të një ekosistemi industrial resilient (qëndrueshëm), të dixhitalizuar dhe të integruar në zinxhirët e vlerave ndërkombëtare. Kostoja indikative e përgjithshme për këtë shtyllë është rishikuar nga 152.7 mln lekë në 330.15 mln lekë. Vlera e financimit e parashikuar për financim nga buxheti i shtetit për këtë shtyllë rritet nga 66.88 mln lekë në 237.63 mln lekë. Hendeku financiar nga 84.22 mln lekë (në planifikimin e mëparshëm) është ulur në 29.40 mln lekë, ndërsa mbështetja e synuar nga partnerët implementues rritet nga 1.6 mln lekë në 63.12 mln lekë. Rritja e kostos totale nga 152.7 mln lekë në 327.17 mln lekë reflekton një rialokim drejt programeve me ndikim të lartë në zhvillimin ekonomik. Duke përfshirë masa të reja (si dixhitalizimi industrial, ekonomia qarkulluese dhe certifikimi), Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit synon që të investojë në "infrastrukturën e eksportuesit".

Pjesa më e madhe e buxhetit të ri të parashikuar në strategji është alokuar për masa të reja strategjike, si:

- Dixhitalizimi Industrial dhe AI (1.1.8): Me një vlerë prej 37.2 mln lekë gjithsej (nga ku financim nga buxheti i shtetit planifikuar në PBA 2027-2029 në masën 22.58 mln lekë), kjo masë synon të ngrejë kapacitetet teknike për zbatimin e Projektit DIU - Digital Innovation Unit me qëllim rritjen e produktivitetit të ndërmarrjeve prodhuese përmes integrimit të teknologjive të avancuara dhe shfrytëzimit të Inteligjencës Artificiale.
- Standardet, certifikimi dhe gatishmëria për tregun e vetëm (me modul ndërkombëtarizimi). Kjo masë përfaqëson një ndërhyrje strategjike për transformimin e konkurrueshmërisë së sektorit privat shqiptar në kuadër të integrimit evropian. Nëpërmjet këtij programi, MEI synon të tejkalojë barrierat strukturore që pengojnë ndërmarrjet vendase (NMVM) të operojnë efektivisht në Tregun e Vetëm të Bashkimit Evropian. Programi nuk shihet thjesht si një proces përputhshmërie ligjore, por si një platformë transformuese që lidh reformat institucionale me nevojat konkrete të sipërmarrjes. Me një buxhet të fazës së parë prej 1.5 milion € (144.8 milion lekë), të financuar nga buxheti i shtetit nëpërmjet marrëveshjes së bashkëpunimit mes SASPAK dhe UNDP, kjo masë garanton shfrytëzimin efikas të fondeve për ndërgjegjësimin e 48,000 ndërmarrjeve në nivel kombëtar.
- Programi Kombëtar i Zhvillimit të Klasterave Industriale dhe Integrimi në Zinxhirët e IHD-ve: Masa është konceptuar si një instrument me kosto të menaxhueshme dhe impakt të lartë, ku buxheti i planifikuar për periudhën 2027–2030 (7.3 milion lekë për menaxhimin e klasterave) shërben si katalizator për gjenerimin e një vëllimi kontratash furnizimi prej të paktën 25 milion euro deri në vitin 2030. Duke ndërlidhur stimujt për investitorët e huaj me rezultate të matshme në integrimin lokal, MEI synon të ndërtojë një zinxhir furnizimi të konsoliduar, që mundëson që investimet e huaja të gjenerojnë "përfitime të shumëfishta" në ekonominë shqiptare. Nëpërmjet kësaj mase, Shqipëria do të konsolidojë pozicionin e saj si një vend partner në zinxhirët evropianë të vlerës, duke rritur produktivitetin e NMVM-ve dhe qëndrueshmërinë e sektorit industrial vendas.

Duke mbështetur ndërmarrjet në certifikimin ndërkombëtar (CE/ISO) dhe në aksesin në tregjet e BE-së, strategjia e rishikuar krijon një politikë të qëndrueshme për rritjen e eksporteve dhe krijimin e vendeve të punës me vlerë të shtuar të lartë.

- **Shtylla 1.2 "Zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni"**

Rishikimi i Shtyllës 1.2 "Zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni" reflekton një ndryshim të rëndësishëm strategjik, duke kaluar nga një model i bazuar në skema tradicionale të granteve të fragmentuara drejt një qasjeje të integruar që mbështetet në instrumente

asistenca teknike e drejtpërdrejtë drejt ndërtimit të një ekosistemi industrial resilient (qëndrueshëm), të dixhitalizuar dhe të integruar në zinxhirët e vlerave ndërkombëtare. Kostoja indikative e përgjithshme për këtë shtyllë është rishikuar nga 152.7 mln lekë në 330.15 mln lekë. Vlera e financimit e parashikuar për financim nga buxheti i shtetit për këtë shtyllë rritet nga 66.88 mln lekë në 237.63 mln lekë. Hendeku financiar nga 84.22 mln lekë (në planifikimin e mëparshëm) është ulur në 29.40 mln lekë, ndërsa mbështetja e synuar nga partnerët implementues rritet nga 1.6 mln lekë në 63.12 mln lekë. Rritja e kostos totale nga 152.7 mln lekë në 327.17 mln lekë reflekton një rialokim drejt programeve me ndikim të lartë në zhvillimin ekonomik. Duke përfshirë masa të reja (si dixhitalizimi industrial, ekonomia qarkulluese dhe certifikimi), Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit synon që të investojë në "infrastrukturën e eksportuesit".

Pjesa më e madhe e buxhetit të ri të parashikuar në strategji është alokuar për masa të reja strategjike, si:

- Dixhitalizimi Industrial dhe AI (1.1.8): Me një vlerë prej 37.2 mln lekë gjithsej (nga ku financim nga buxheti i shtetit planifikuar në PBA 2027-2029 në masën 22.58 mln lekë), kjo masë synon të ngrejë kapacitetet teknike për zbatimin e Projektit DIU - Digital Innovation Unit me qëllim rritjen e produktivitetit të ndërmarrjeve prodhuese përmes integrimit të teknologjive të avancuara dhe shfrytëzimit të Inteligjencës Artificiale.
- Standardet, certifikimi dhe gatishmëria për tregun e vetëm (me modul ndërkombëtarizimi). Kjo masë përfaqëson një ndërhyrje strategjike për transformimin e konkurrueshmërisë së sektorit privat shqiptar në kuadër të integrimit evropian. Nëpërmjet këtij programi, MEI synon të tejkalojë barrierat strukturore që pengojnë ndërmarrjet vendase (NMVM) të operojnë efektivisht në Tregun e Vetëm të Bashkimit Evropian. Programi nuk shihet thjesht si një proces përputhshmërie ligjore, por si një platformë transformuese që lidh reformat institucionale me nevojat konkrete të sipërmarrjes. Me një buxhet të fazës së parë prej 1.5 milion € (144.8 milion lekë), të financuar nga buxheti i shtetit nëpërmjet marrëveshjes së bashkëpunimit mes SASPAK dhe UNDP, kjo masë garanton shfrytëzimin efikas të fondeve për ndërgjegjësimin e 48,000 ndërmarrjeve në nivel kombëtar.
- Programi Kombëtar i Zhvillimit të Klasterave Industriale dhe Integrimi në Zinxhirët e IHD-ve: Masa është konceptuar si një instrument me kosto të menaxhueshme dhe impakt të lartë, ku buxheti i planifikuar për periudhën 2027–2030 (7.3 milion lekë për menaxhimin e klasterave) shërben si katalizator për gjenerimin e një vëllimi kontratash furnizimi prej të paktën 25 milion euro deri në vitin 2030. Duke ndërlidhur stimujt për investitorët e huaj me rezultate të matshme në integrimin lokal, MEI synon të ndërtojë një zinxhir furnizimi të konsoliduar, që mundëson që investimet e huaja të gjenerojnë "përfitime të shumëfishta" në ekonominë shqiptare. Nëpërmjet kësaj mase, Shqipëria do të konsolidojë pozicionin e saj si një vend partner në zinxhirët evropianë të vlerës, duke rritur produktivitetin e NMVM-ve dhe qëndrueshmërinë e sektorit industrial vendas.

Duke mbështetur ndërmarrjet në certifikimin ndërkombëtar (CE/ISO) dhe në aksesin në tregjet e BE-së, strategjia e rishikuar krijon një politikë të qëndrueshme për rritjen e eksporteve dhe krijimin e vendeve të punës me vlerë të shtuar të lartë.

- **Shtylla 1.2 "Zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni"**

Rishikimi i Shtyllës 1.2 "Zhvillimi i NVM-ve, sipërmarrja dhe inovacioni" reflekton një ndryshim të rëndësishëm strategjik, duke kaluar nga një model i bazuar në skema tradicionale të granteve të fragmentuara drejt një qasjeje të integruar që mbështetet në instrumente

financiare alternative dhe modernizim teknologjik. Kostoja indikative e përgjithshme për këtë shtyllë është përditësuar nga 9.27 miliardë lekë (në periudhën 2021-2027) në 6.46 miliardë lekë për periudhën 2026-2030, duke rishikuar dhe përmirësuar përdorimin e burimeve nga buxheti i shtetit. Vlera e financimit nga buxheti i shtetit për këtë shtyllë, është parashikuar në 5.53 miliardë lekë, krahasuar me 6.69 miliardë lekë në planifikimin e mëparshëm 2021-2027. Hendeku financiar është rritur nga 425.21 mln lekë në 893.55 mln lekë, ndërsa riorientimi i fondeve drejt masave me ndikim të lartë synon një përputhshmëri më të mirë me objektivat e konkurrueshmërisë deri në vitin 2030.

Pjesa më e madhe e buxhetit të ri është alokuar për masa të reja strategjike që nxisin modernizimin e industrisë dhe zhvillimin e ekosistemit të sipërmarrjes, si:

- Instrumente financiare për modernizimin (1.2.9): Me një vlerë prej 5.02 miliardë lekë (përfshirë garancinë sovrane dhe asistencën teknike për biznesin), kjo është masa kryesore e shtyllës, e cila fokusohet në mobilizimin e kapitalit privat përmes huave të garantuara. Ky instrument synon të gjenerojë investime private, duke ndihmuar ndërmarrjet prodhuese të modernizojnë pajisjet dhe proceset e tyre. Pavarësisht se masa reflektohet në tavanet e PBA-së si një angazhim fiskal për qëllime të menaxhimit të riskut dhe likuiditetit, ajo është konceptuar si një instrument "levë financiare" dhe jo si një transferim buxhetor. Ky buxhet nuk shpenzohet si grant, por shërben si një bazë garancie që mundëson mobilizimin e një portofoli kredish bankare shumë herë më të madh në sektorin privat.
- Transferimi i teknologjisë dhe qeverisja e S3 (1.2.7): Me një vlerë prej 24 mln lekë, kjo masë mbështet ndërmarrjet në rrugën drejt inovacionit, duke nxitur bashkëpunimin industri–kërkim shkencor dhe duke rritur numrin e ndërmarrjeve me veprimtari inovative. Kjo masë synon të krijojë një ekosistem ku bizneset gjejnë ekspertizën e duhur kërkimore për modernizimin e proceseve.
- Rritja e aksesit në financë (1.2.8): Me një vlerë prej 449.4 mln lekë, programi fokusohet në mbështetjen e vazhdueshme të NVM-ve përmes AIDA me fonde grant të cilat bazuar në ligjin nr. 43/2022 "Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme" synon zbatimin e programeve që synojnë rritjen e konkurrueshmërisë, artizanatit, zhvillimin e të mësuarit rreth ndërmarrjes, zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të reja si rezultat i kërkim-zhvillimit, zhvillimin e aftësive të ndërmarrjes, inovacionin, rinovimin e teknologjisë, ndërkombëtarizimin e zhvillimin e NMVM-ve dhe mbështetjen e grave sipërmarrëse.
- SME Test dhe Paketa e Dekarbonizimit: Duke mbështetur NVM-të përmes instrumenteve financiare të aksesueshme, certifikimit dhe përafrimit me standardet e BE-së (si *SME Test* dhe *Paketa e Dekarbonizimit*), strategjia e rishikuar krijon një politikë të qëndrueshme për rritjen e produktivitetit, konkurrueshmërisë në tregun e vetëm dhe integrimin e plotë të ndërmarrjeve shqiptare në zinxhirët e vlerave globale.
- Skema e re "Scale up" e parashikuar me hendek financiar në shumën 482.4 mln lekë do të synojë forcimin e konkurrueshmërisë së biznesit. Shqiperia planifikon të aplikojë në programet e Unionit.

- **Shtylla 1.3 "Zhvillimi i kapitalit njerëzor"**

Rishikimi i Shtyllës 1.3 "Zhvillimi i kapitalit njerëzor" reflekton një rishikim të prioriteteve drejt nevojave të tregut të punës për aftësi të reja dixhitale dhe të gjelbra, duke siguruar një përputhshmëri më të mirë ndërmjet sistemit arsimor/trajnues dhe kërkesave të industrisë.

financiare alternative dhe modernizim teknologjik. Kostoja indikative e përgjithshme për këtë shtyllë është përditësuar nga 9.27 miliardë lekë (në periudhën 2021-2027) në 6.46 miliardë lekë për periudhën 2026-2030, duke rishikuar dhe përmirësuar përdorimin e burimeve nga buxheti i shtetit. Vlera e financimit nga buxheti i shtetit për këtë shtyllë, është parashikuar në 5.53 miliardë lekë, krahasuar me 6.69 miliardë lekë në planifikimin e mëparshëm 2021-2027. Hendeku financiar është rritur nga 425.21 mln lekë në 893.55 mln lekë, ndërsa riorientimi i fondeve drejt masave me ndikim të lartë synon një përputhshmëri më të mirë me objektivat e konkurrueshmërisë deri në vitin 2030.

Pjesa më e madhe e buxhetit të ri është alokuar për masa të reja strategjike që nxisin modernizimin e industrisë dhe zhvillimin e ekosistemit të sipërmarrjes, si:

- Instrumente financiare për modernizimin (1.2.9): Me një vlerë prej 5.02 miliardë lekë (përfshirë garancinë sovrane dhe asistencën teknike për biznesin), kjo është masa kryesore e shtyllës, e cila fokusohet në mobilizimin e kapitalit privat përmes huave të garantuara. Ky instrument synon të gjenerojë investime private, duke ndihmuar ndërmarrjet prodhuese të modernizojnë pajisjet dhe proceset e tyre. Pavarësisht se masa reflektohet në tavanet e PBA-së si një angazhim fiskal për qëllime të menaxhimit të riskut dhe likuiditetit, ajo është konceptuar si një instrument "levë financiare" dhe jo si një transferim buxhetor. Ky buxhet nuk shpenzohet si grant, por shërben si një bazë garancie që mundëson mobilizimin e një portofoli kredish bankare shumë herë më të madh në sektorin privat.
- Transferimi i teknologjisë dhe qeverisja e S3 (1.2.7): Me një vlerë prej 24 mln lekë, kjo masë mbështet ndërmarrjet në rrugën drejt inovacionit, duke nxitur bashkëpunimin industri–kërkim shkencor dhe duke rritur numrin e ndërmarrjeve me veprimtari inovative. Kjo masë synon të krijojë një ekosistem ku bizneset gjejnë ekspertizën e duhur kërkimore për modernizimin e proceseve.
- Rritja e aksesit në financë (1.2.8): Me një vlerë prej 449.4 mln lekë, programi fokusohet në mbështetjen e vazhdueshme të NVM-ve përmes AIDA me fonde grant të cilat bazuar në ligjin nr. 43/2022 "Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme" synon zbatimin e programeve që synojnë rritjen e konkurrueshmërisë, artizanatit, zhvillimin e të mësuarit rreth ndërmarrjes, zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të reja si rezultat i kërkim-zhvillimit, zhvillimin e aftësive të ndërmarrjes, inovacionin, rinovimin e teknologjisë, ndërkombëtarizimin e zhvillimin e NMVM-ve dhe mbështetjen e grave sipërmarrëse.
- SME Test dhe Paketa e Dekarbonizimit: Duke mbështetur NVM-të përmes instrumenteve financiare të aksesueshme, certifikimit dhe përafrimit me standardet e BE-së (si *SME Test* dhe *Paketa e Dekarbonizimit*), strategjia e rishikuar krijon një politikë të qëndrueshme për rritjen e produktivitetit, konkurrueshmërisë në tregun e vetëm dhe integrimin e plotë të ndërmarrjeve shqiptare në zinxhirët e vlerave globale.
- Skema e re "Scale up" e parashikuar me hendek financiar në shumën 482.4 mln lekë do të synojë forcimin e konkurrueshmërisë së biznesit. Shqiperia planifikon të aplikojë në programet e Unionit.

- **Shtylla 1.3 "Zhvillimi i kapitalit njerëzor"**

Rishikimi i Shtyllës 1.3 "Zhvillimi i kapitalit njerëzor" reflekton një rishikim të prioriteteve drejt nevojave të tregut të punës për aftësi të reja dixhitale dhe të gjelbra, duke siguruar një përputhshmëri më të mirë ndërmjet sistemit arsimor/trajnues dhe kërkesave të industrisë.

Kostoja indikative e përgjithshme për këtë shtyllë është rishikuar nga 181.14 mln lekë në 98.64 mln lekë. Për masat 1.3.3, 1.3.5 dhe 1.3.6, nuk është parashikuar një kosto e veçantë pasi ato janë hartuar si masa ndërsektoriale. Shpenzimet operacionale për këto aktivitete (si ndërgjegjësimi i biznesit apo vlerësimi i nevojave) mbulohen nga buxheti i përgjithshëm i funksionimit të strukturave ekzistuese të Ministrisë dhe AIDA-s, duke shmangur planifikimin më të lartë të shpenzimeve pasi aktivitetet përputhen me funksionet ekzistuese të institucioneve kontribuese.

Për sa më lart, për realizimin e Qëllimit të Politikës (P1) "Zhvillimi plotësisht i potencialeve të investimeve për zhvillimin ekonomik dhe nxitjen e integrimit në tregjet ndërkombëtare dhe zinxhirët e vlerës", nevojat gjithsej financiare për periudhën e rishikuar 2026–2030 (të konsoliduara me ecurinë historike të strategjisë) janë llogaritur në 6.41 miliardë lekë (afërsisht 66.41 milionë euro). Kjo kosto është e natyrës shpenzime korente, duke reflektuar fokusin e strategjisë në aktivitetet operacionale, mbështetjen teknike, skemat e asistencës dhe zhvillimin e kapaciteteve njerëzore për të mundësuar integrimin e NVM-ve në zinxhirët globalë të vlerës. Ecuria e përgjithshme e financimit dhe hendeku mbetur fiskal paraqiten në Tabelën nr. 1 si vijon:

Tabela nr.1: Tabela përmbledhese e financimit

**Nevojat kapitale (në Lek)**

| Qëllimi i Politikës | Tipologjia e kostos | Kostoja Totale 2021-2030 | Kostot e Planifikuara PBA 2021-2030 Buxheti dhe Donatoret | Hendeku Financiar 2021-2030 |
|---|---|---|---|---|
| **P1 Zhvillimi plotësisht i potencialeve të investimeve për zhvillimin ekonomik dhe nxitjen e integrimit në tregjet ndërkombëtare dhe zinxhirët e vlerës.** | Korente | 6,896,834,179 | 5,875,235,599 | ***1,021,598,580*** |
| | Kapitale | 0 | 0 | |
| **TOTALI [Leke]** | | **6,896,834,179** | **5,875,235,599** | ***1,021,598,580*** |
| **TOTALI [Euro]** *1 euro 96.54 Leke* | | **71,440,172** | **60,858,044** | ***10,582,127*** |

Kostoja indikative e përgjithshme për këtë shtyllë është rishikuar nga 181.14 mln lekë në 98.64 mln lekë. Për masat 1.3.3, 1.3.5 dhe 1.3.6, nuk është parashikuar një kosto e veçantë pasi ato janë hartuar si masa ndërsektoriale. Shpenzimet operacionale për këto aktivitete (si ndërgjegjësimi i biznesit apo vlerësimi i nevojave) mbulohen nga buxheti i përgjithshëm i funksionimit të strukturave ekzistuese të Ministrisë dhe AIDA-s, duke shmangur planifikimin më të lartë të shpenzimeve pasi aktivitetet përputhen me funksionet ekzistuese të institucioneve kontribuese.

Për sa më lart, për realizimin e Qëllimit të Politikës (P1) "Zhvillimi plotësisht i potencialeve të investimeve për zhvillimin ekonomik dhe nxitjen e integrimit në tregjet ndërkombëtare dhe zinxhirët e vlerës", nevojat gjithsej financiare për periudhën e rishikuar 2026–2030 (të konsoliduara me ecurinë historike të strategjisë) janë llogaritur në 6.41 miliardë lekë (afërsisht 66.41 milionë euro). Kjo kosto është e natyrës shpenzime korente, duke reflektuar fokusin e strategjisë në aktivitetet operacionale, mbështetjen teknike, skemat e asistencës dhe zhvillimin e kapaciteteve njerëzore për të mundësuar integrimin e NVM-ve në zinxhirët globalë të vlerës. Ecuria e përgjithshme e financimit dhe hendeku mbetur fiskal paraqiten në Tabelën nr. 1 si vijon:

Tabela nr.1: Tabela përmbledhese e financimit

**Nevojat kapitale (në Lek)**

| Qëllimi i Politikës | Tipologjia e kostos | Kostoja Totale 2021-2030 | Kostot e Planifikuara PBA 2021-2030 Buxheti dhe Donatoret | Hendeku Financiar 2021-2030 |
|---|---|---|---|---|
| **P1 Zhvillimi plotësisht i potencialeve të investimeve për zhvillimin ekonomik dhe nxitjen e integrimit në tregjet ndërkombëtare dhe zinxhirët e vlerës.** | Korente | 6,896,834,179 | 5,875,235,599 | ***1,021,598,580*** |
| | Kapitale | 0 | 0 | |
| **TOTALI [Leke]** | | **6,896,834,179** | **5,875,235,599** | ***1,021,598,580*** |
| **TOTALI [Euro]** *1 euro 96,54 Leke* | | **71,440,172** | **60,858,044** | ***10,582,127*** |




Financimi i planit të veprimit të zbatimit të Strategjisë së rishikuar për do të realizohet nga disa burime, por buxheti i shtetit, fondet e NJVV-së dhe mbështetja financiare e donatorëve mbeten burimet kryesore. Për periudhën 2026–2030, buxheti i shtetit pritet të financojë zbatimin e planit në masën 83.69 % të financimit të nevojshëm, 1.50 % pritet të financohet nga partnerët për implementim, ndërsa 14.81 % është hendek financiar.

Impakti Financiar i Masave të Reja (Periudha 2026–2030)

Në kuadër të rishikimit strategjik dhe shtrirjes së afatit të strategjisë deri në vitin 2030, paketa e ndërhyrjes është përditësuar me 15 masa të reja strukturore (ku përfshihen instrumentet e reja të modernizimit, dekarbonizimit industrial dhe paketa e gatishmërisë për Tregun e Vetëm). Për të garantuar disiplinën fiskale, këto 15 masa të reja janë kuantifikuar dhe programuar në mënyrë të tillë që kostot e tyre të mbulohen nga alokimet e parashikuara në PBA dhe nga marrëveshjet ekzistuese me donatorët (si SASPAK-UNDP, etj.). Vlerësimet financiare të paraqitura për këto masa kanë karakter indikativ, bazuar në analizat paraprake të kostimit dhe nevojave operacionale. Këto shifra do t'i nënshtrohen procesit të rishikimit dhe përditësimit gjatë ciklit të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) në vijim, duke u përfshirë brenda tavaneve të miratuara për MEI sipas prioriteteve të përcaktuara në këtë strategji. Siç pasqyrohet në Tabelën nr. 2, integrimi i këtyre masave në strategji është konceptuar në mënyrë që të mos gjenerojë hendek të ri financiar përtej hapësirave të miratuara, duke ruajtur qëndrueshmërinë afatmesme dhe duke garantuar se çdo masë e re është në përputhje me angazhimet buxhetore të MEI.

Tabela nr. 2: Tabela përmbledhese e financimit për 15 masat e reja në strategji




Financimi i planit të veprimit të zbatimit të Strategjisë së rishikuar për do të realizohet nga disa burime, por buxheti i shtetit, fondet e NJVV-së dhe mbështetja financiare e donatorëve mbeten burimet kryesore. Për periudhën 2026–2030, buxheti i shtetit pritet të financojë zbatimin e planit në masën 83.69 % të financimit të nevojshëm, 1.50 % pritet të financohet nga partnerët për implementim, ndërsa 14.81 % është hendek financiar.

Impakti Financiar i Masave të Reja (Periudha 2026–2030)

Në kuadër të rishikimit strategjik dhe shtrirjes së afatit të strategjisë deri në vitin 2030, paketa e ndërhyrjes është përditësuar me 15 masa të reja strukturore (ku përfshihen instrumentet e reja të modernizimit, dekarbonizimit industrial dhe paketa e gatishmërisë për Tregun e Vetëm). Për të garantuar disiplinën fiskale, këto 15 masa të reja janë kuantifikuar dhe programuar në mënyrë të tillë që kostot e tyre të mbulohen nga alokimet e parashikuara në PBA dhe nga marrëveshjet ekzistuese me donatorët (si SASPAK-UNDP, etj.). Vlerësimet financiare të paraqitura për këto masa kanë karakter indikativ, bazuar në analizat paraprake të kostimit dhe nevojave operacionale. Këto shifra do t'i nënshtrohen procesit të rishikimit dhe përditësimit gjatë ciklit të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) në vijim, duke u përfshirë brenda tavaneve të miratuara për MEI sipas prioriteteve të përcaktuara në këtë strategji. Siç pasqyrohet në Tabelën nr. 2, integrimi i këtyre masave në strategji është konceptuar në mënyrë që të mos gjenerojë hendek të ri financiar përtej hapësirave të miratuara, duke ruajtur qëndrueshmërinë afatmesme dhe duke garantuar se çdo masë e re është në përputhje me angazhimet buxhetore të MEI.

Tabela nr. 2: Tabela përmbledhese e financimit për 15 masat e reja në strategji

**Nevojat kapitale (në Lek)**

| Qëllimi i Politikës | Tipologjia e kostos | Kostoja Totale 2021-2030 | Kostot e Planifikuara PBA 2021-2030 Buxheti dhe Donatoret | Hendeku Financiar 2021-2030 |
|---|---|---|---|---|
| **P1 Zhvillimi plotësisht i potencialeve të investimeve për zhvillimin ekonomik dhe nxitjen e integrimit në tregjet ndërkombëtare dhe zinxhirët e vlerës.** | Korente | 5,759,336,002 | 5,276,936,002 | ***482,400,000*** |
| | Kapitale | 0 | 0 | |
| **TOTALI [Lekë]** | | **5,759,336,002** | **5,276,936,002** | ***482,400,000*** |
| **TOTALI [Euro]** *1 euro 96.54 Leke* | | **59,657,510** | **54,660,617** | ***4,996,892*** |

**MINISTËR**

**Delina Ibrahimaj**

Delina Ibrahimaj

Digitally signed by Delina Ibrahimaj
Date: 2026.07.13 17:09:58 +02'00'